



*Republika e Kosovës*  
*Republika Kosova - Republic of Kosovo*

*Komuna e Prishtinës*  
*Opština Priština - Municipality of Prishtina*

Në mbështetje të nenit 5, paragrafit 5.2, të nenit 16, të Ligjit nr. 03/L-087, për ndërmarrjet publike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 31/15 qershor 2008), të nenit 164 të Ligjit nr. 06/L-016 për shoqëritë tregtare, të konkursit të shpallur me dt. 04.08.2020 deri me 19.08.2020 për 4 anëtarë të bordit të drejtorëve të ndërmarrjes publike lokale "Kuzhina Qendrore" Sh.A., Komisioni komunal i aksionarëve për ndërmarrjen publike lokale "Kuzhina Qendrore" Sh.A, në mbledhjen e mbajtur me 10.09.2020, merr këtë:

## V E N D I M

### Neni 1

Emërohen anëtarë të bordit të drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Lokale "Kuzhina Qendrore" SH.A. si vijon:

1. Shqipe Breznica,
2. Alban Berisha,
3. Muhamet Bytyqi,
4. Qëndrim Vitija.

### Neni 2

Detyrat e anëtarëve të bordit të drejtorëve janë të përcaktuara në Ligjin nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike dhe Ligjin nr. 06/L-016 për shoqëritë tregtare.

### Neni 3

Kompensimi i bordit të drejtorëve do të bëhet në pajtim me dispozitat e nenit 20 të Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike dhe nenit 161 të Ligjit nr. 06/L-016 për shoqëritë tregtare.

#### Neni 4

Për kryerjen e detyrave të përcaktuara si në pikën 2 të këtij Vendimi, Bordi i drejtorëve i raporton Komisionit komunal të aksionarëve.

#### Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

#### U dorëzohet:

- Të emëruarve;
- Në dosje.

#### KOMISIONI KOMUNAL I AKSIONARËVE:

Naim Jakaj

Fiknete Bejta

Mustafë Krasniqi

